

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

RAPORT MBI PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË.

VITI AKADEMIK 2025-2026

TIRANË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE 1

RAPORT MBI PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË. 1

VITI AKADEMIK 2025-2026 1

Parathënie 3

Shënime për raportin 4

Kreu I 5

Procesi i Pranimeve në nivel kombëtar 5

Kreu II 5

Regjistrimet në nivel sistemi shkollimi (IAL publike/jopublike) 6

Kreu III 7

Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL-je Tabela 1 7

Kreu IV 9

Regjistrimet sipas kuotave 9

Kreu V 12

Procesi i regjistrimeve në nivel program studimi 12

Kreu VI 13

Regjistrimet sipas gjinisë 13

Kreu VII 14

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL 14

Kreu VIII 18

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas intervaleve të notës mesatare sipas IAL 18

Kreu IX 25

Procesi i pranimit në programet e studimit të fushës mësuesi 25

Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi 25

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e mësuesisë 27

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notës mesatare 30

Kreu X 36

Procesi i pranimit në programet e studimit të gjuhëve të huaja 36

Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi 36

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e gjuhëve të huaja 37

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notës mesatare 39

Parathënie

Ky raport ka për qëllim, jo vetëm të pasqyrojë procesin e regjistrimeve në programet e ciklit të parë dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, për vitin akademik 2025-2026, në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), por edhe të orientojë më qartësisht vendimmarrësit në fushën e arsimit, maturantët dhe kandidatët për studentë, gjatë përzgjedhjes së tyre për programet e studimit që ofrohen nga Institucionet e Arsimit të Lartë, IAL-të publike dhe jopublike, në hartimin e strategjive më të mira për përmirësimin e kurrikulave dhe programeve të reja të studimeve, për informimin e maturantëve dhe kandidatëve rreth programeve të studimit që ofrojnë, si dhe orientimin e tyre në tregun e punës në të ardhmen.

Gjithashtu, synohet një ndërgjegjësim më i mirë i kandidatëve për student, për t'u fokusuar më mirë në ato programe studimi, ku ata mund të arrijnë potencialin e tyre maksimal dhe ku kanë më shumë mundësi të pranohen.

Meqenëse kriteret e pranimit, të vendosura nga IAL-të, mbështeten kryesisht në arritjet e maturantëve dhe kandidatëve në arsimin e mesëm të lartë, si dhe duke qenë ky filtri kryesor hyrës në IAL, mund të themi se, tërheqja e studentëve cilësorë është një faktor i rëndësishëm, që ndikon edhe cilësinë në vijueshmërinë e studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky material jep informacion mbi studentët e pranuar në IAL, si edhe nivelin e studentëve hyrës sipas kriterit të notës mesatare. Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që bën të mundur, jo vetëm njohjen e cilësisë së studentëve të pranuar në nivel kombëtar, por edhe në nivel IAL-je dhe programi studimi.

Gjithashtu, ky raport bën edhe një pasqyrim të procesit të pranimeve për vitin akademik 2025-2026 për programet e studimit, të cilat mund të profilizohen në mësuesi si dhe në programet e gjuhëve të huaja.

Shënime për raportin

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e të dhënave, të krijuar nga QSHA për:

- Realizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2025.
- Mbledhjen e të dhënave për arsimin e mesëm të lartë nga shkollat dhe përllogaritjen e notës mesatare sipas VKM Nr. 436 , datë 03.06.2020 i ndryshuar , për çdo maturant/kandidat aplikues.
- Kuotat e verifikuara dhe të certifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për kategorinë shqiptarë brenda vendit.
- Regjistrimet e studentëve në portalin U-Albania për vitin akademik 2025-2026 (cikli i parë i studimeve, për kategorinë shqiptarë brenda vendit).

Maturantët dhe kandidatët aplikuan në Portalin U-Albania, në tre raunde aplikimi, duke përzgjedhur deri në 10 preferenca, si dhe kryen regjistrimin në tre raunde pasuese në Portalin U-Albania, për pranimet në ciklin e parë të studimeve, të vitit akademik 2025-2026.

Vëmë në dukje se, në vitet akademike 2023-2024, 2024-2025 dhe 2025-2026, mbështetur në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, u përcaktua si kriter aplikimi e pranimi në Institucionet e Arsimit të Lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, nota mesatare minimale 6.5. Gjithashtu, për programet e studimit, të cilat profilizohen në mësuesi, nota mesatare minimale 7.5. Kjo notë është përllogaritur si mesatare aritmetike e thjeshtë e dy treguesve:

1. Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit të arsimit të mesëm të lartë.
2. Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 436, datë 03.06.2020 i ndryshuar, nisur nga viti 2019-2020 dhe këtë vit akademik 2025-2026, u përcaktua si kriter aplikimi e pranimi në Institucionet e Arsimit të Lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, nota mesatare minimale 6.5 . Gjithashtu, për programet e studimit, të cilat profilizohen në mësuesi, nota mesatare minimale është 7.5.

Po sipas këtyre vendimeve, për programet e studimit dyvjeçare, me karakter profesional, për programet në fushën e artit dhe sportit, nuk është detyrim kriteri i notës mesatare 6.5, sipas përcaktimit të mësipërm.

Kreu I

Procesi i Pranimeve në nivel kombëtar

Në nivel kombëtar, gjatë vitit akademik **2025-2026**, u ofruan:

- **590** programe studimi, nga të cilat:
  - **349** nga IAL-të publike;
  - **241** nga IAL-të jopublike.

Programe të studimit dyvjeçare me karakter profesional u ofruan gjithsej **95,** nga të cilat:

- **48** nga IAL-të publike;
- **47** nga IAL-të jopublike.

Për programet e studimit të ciklit të parë, ato dyvjeçare me karakter profesional dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, për kategorinë shqiptarë brenda vendit, për këtë vit akademik, **në tërësi** u ofruan:

- **31475** kuota nga të cilat:
  - **19466** kuota nga IAL-të publike;
  - **12009** kuota nga IAL-të jopublike.

Në programet e studimit të ofruara në ciklin e parë për vitin akademik 2025-2026 **u regjistruan** më shumë studentë sesa në vitin akademik 2024-2025:

Viti akademik	2024-2025	2025-2026
Publik	**13872**	**14199**
JoPublik	**7674**	**7769**
Totali	**21546**	**21968**

Kreu II


Regjistrimet në nivel sistemi shkollimi (IAL publike/jopublike)

Regjistrimet në IAL-të publike dhe jopublike, krahasuar me regjistrimet në total, pasqyrojnë një shpërndarje në përqindje, të paraqitur në **Grafikun 1,** si më poshtë.

IAL-të publike zënë pjesën më të madhe të regjistrimeve **me:**

- **64.63%** të tyre.

Pjesa më e madhe e regjistrimeve të studentëve vazhdon të jetë e orientuar drejt IAL-ve publike.



Grafik 1


Kreu III

Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL-je

Tabela 1

Universitetet Publike dhe Jopublike	Shpërndarja e regjistrimeve në nivel IAL
UNIVERSITETI I TIRANËS	15.79%
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	8.45%
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	7.31%
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	6.44%
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	5.51%
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	4.79%
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	4.28%
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	4.26%
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	4.25%
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	3.75%
UNIVERSITETI ALDENT	3.36%
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	3.07%
UNIVERSITETI BARLETI	2.94%
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	2.56%
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	2.37%
UNIVERSITETI EPOKA	2.26%
UNIVERSITETI POLIS	2.20%
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	2.12%
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	1.41%
UNIVERSITETI LUARASI	1.34%
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	1.23%
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	1.08%
KOLEGJI UNIVERSITAR INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË	1.05%
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	1.01%
KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	0.95%
TIRANA COLLEGE OF TECHNOLOGY (ish KPT)	0.89%
UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	0.84%
KOLEGJI UNIVERSITAR REALD	0.69%
AKADEMIA E SIGURISË	0.68%
KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI	0.67%
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE	0.61%
AKADEMIA IVODENT	0.55%
KOLEGJI PROFESIONAL I LARTE GJERMAN I TEKNOLOGJISE	0.33%
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	0.32%
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA	0.31%
TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL	0.20%
Akademia American Academy of Technology Tirana	0.08%
AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI	0.05%
KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	0.02%

Tabela 1 tregon përqindjen e studentëve të regjistruar në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2025-2026**.**



Grafik 2

Nga tabela rezulton se, numri më i madh i studentëve të regjistruar i përket:

- **Universitetit të Tiranës** me **15.79%,** i cili gjithashtu ofron edhe numrin më të madh të kuotave, me **4481,** në **42** programe studimi.

- **Universiteti i Durrësit** me **8.45%** të studentëve të regjistruar, i cili vjen i dyti në renditje, për nga numri i kuotave të ofruara, me **2762** të tilla, në **61** programe studimi.


Kreu IV

Regjistrimet sipas kuotave

Për vitin akademik 2025-2026, vetëm 69.80% e totalit të kuotave janë plotësuar me regjistrime.

Janë plotësuar me regjistrime nga:

- IAL-të publike – **72.91%** e kuotave;
- IAL-të jopublike - **64.75**% e kuotave.



Grafik 3

Nisur nga përqindja më e lartë e plotësimit të kuotave në IAL-të publike, mund të themi se pjesa më e madhe e studentëve preferojnë të regjistrohen në këto IAL.

Plotësimi i kuotave me regjistrime për Institucionet e Arsimit të Lartë

Tabela 2 tregon plotësimin e kuotave me studentë të regjistruar për çdo IAL.

Përqindjen më të lartë të plotësimit të kuotave të ofruara në IAL publike e kanë:

- **Akademia e Sigurisë** me 100 % të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti i Mjekësisë,** me 97.45% të kuotave të plotësuara.
- **Akademia e Forcave të Armatosura,** me 97.14 % të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti Eqerem Çabej Gjirokastër,** me 82.67% të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti Politeknik i Tiranës,** me 80.85% të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti Bujqësor i Tiranës,** me 79.61% të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti i Tiranës,** me 77.39% të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti i Sporteve të Tiranës,** me 100 %, i cili ka edhe specifikën e zhvillimit të konkurseve të pranimit, sipas disiplinave, ku aplikantët paraqesin aftësi nga ana e përgatitjes sportive

Përqindjen më të lartë të plotësimit të kuotave të ofruara në IAL jopublike e kanë:

- **Akademia E Filmit Dhe Multimedias Marubi** me 100 % të kuotave të plotësuara.
- **Universiteti Aldent,** me 92.96 % të kuotave të plotësuara.

Tabela 2

IAL publike/ jopublike	Kuotat të plotësuara në nivel IAL-je
AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI	100.00%
AKADEMIA IVODENT	100.00%
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	100.00%
AKADEMIA E SIGURISË	100.00%
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	97.45%
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA	97.14%
UNIVERSITETI ALDENT	92.96%
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	88.12%
KOLEGJI UNIVERSITAR INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË	86.47%
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	82.67%
UNIVERSITETI POLIS	81.59%
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	80.85%
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	80.63%
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	79.61%
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	78.70%
UNIVERSITETI I TIRANËS	77.39%
UNIVERSITETI EPOKA	74.74%
UNIVERSITETI LUARASI	71.36%
UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	70.50%
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE	68.72%
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	67.20%
TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL	62.86%
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	62.69%
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	60.25%
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	59.20%
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	58.06%
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	57.63%
KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	57.42%
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	54.52%
TIRANA COLLEGE OF TECHNOLOGY (ish KPT)	53.57%
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	53.37%
UNIVERSITETI BARLETI	51.77%
KOLEGJI UNIVERSITAR REALD	47.19%
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	37.32%
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	37.23%
KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI	25.52%
KOLEGJI PROFESIONAL I LARTE GJERMAN I TEKNOLOGJISE	21.82%
Akademia American Academy of Technology Tirana	14.17%
KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	5.71%

Kreu V

Procesi i regjistrimeve në nivel program studimi

Në **Tabelën 3** janë paraqitur 4 programe studimi me kuota të plotësuara 100%.

Tabela 3

Nr	Universiteti	Programi i studimit	Nr i studentëve të regjistruar për program studimi	Kuotat për program studimi	Raporti në % Kuota-Regjistruar
1	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Mjekësi e përgjithshme	**436**	**436**	**100%**
2	UNIVERSITETI I TIRANËS	Financë	**440**	**440**	**100%**
3	UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë Ekonomike	**240**	**240**	**100%**
4	UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	**200**	**200**	**100%**

Për këto katër programe studimi janë plotësuar të gjitha kuotat e miratuara nga MA.

Kreu VI

Regjistrimet sipas gjinisë

Tabela 4 paraqet regjistrimet në nivel kombëtar, sipas gjinisë femra/meshkuj, sipas sistemit publik/jopublik.

Tabela 4

	Studentë të regjistruar total	Në %	Studentë të regjistruar IAL publike	Në %	Studentë të regjistruar IAL jopublike	Në %
Femra	12857	58.53%	8870	62.47%	3987	51.32%
Meshkuj	9111	41.47%	5329	37.53%	3782	48.68%

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se për vitin akademik 2025-2026, në nivel kombëtar:

- numri i studenteve femra është më i madh, krahasuar me numrin e studentëve meshkuj.


Për IAL-të publike rezulton se:

- **62.47%** janë femra.


Për IAL-të jopublike rezulton se:

- **48.68%** janë meshkuj.

Grafikisht shpërndarja e regjistrimeve sipas **gjinisë** paraqitet si në **Grafikët 4** dhe **5**.



Grafik 4



Grafik 5

Kreu VII

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL

Për të analizuar cilësinë e studentëve të regjistruar në ciklin e parë, është përdorur si tregues nota mesatare e përllogaritur sipas VKM Nr. 436, datë 03.06.2020 i ndryshuar.

Kështu në nivel kombëtar kemi:

- Nota mesatare e të gjithë të regjistruarve **7.80**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL publike **7.82.**
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL jopublike **7.76**


Në nivel kombëtar, studentët e regjistruar në IAL publike kanë mesatare më të lartë se studentët e regjistruar në IAL jopublike.

Nga të dhënat e përpunuara rezulton se:

- notën mesatare më të lartë e ka American Academy of Technology Tirana: **9.42**.
- notën mesatare më të ulët e ka Kolegji Universitar Qiriazi (Jopublik): **6.20.**

Tabela 5

Universitete Publike dhe Jopublike	Numri i studentëve të regjistruar për çdo IAL	Mesatarja sipas VKM për çdo IAL
Akademia American Academy of Technology Tirana	17	9.42
AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI	10	8.01
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA	68	8.01
AKADEMIA E SIGURISË	150	7.82
AKADEMIA IVODENT	120	7.26
KOLEGJI PROFESIONAL I LARTE GJERMAN I TEKNOLOGJISE	72	6.57
KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR	4	7.37
KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT	209	6.52
KOLEGJI UNIVERSITAR INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË	230	8.49
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	70	7.07
KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI	148	6.20
KOLEGJI UNIVERSITAR REALD	151	7.10
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE	134	8.28
TIRANA COLLEGE OF TECHNOLOGY (ish KPT)	195	6.34
TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL	44	7.28
UNIVERSITETI ALDENT	739	8.08
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	1856	7.24
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	1211	6.81
UNIVERSITETI BARLETI	645	7.22
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	824	7.56
UNIVERSITETI EPOKA	497	9.01
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	520	6.81
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	941	7.58
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	563	7.01
UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	184	7.52
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	1605	9.09
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS	466	6.73
UNIVERSITETI I TIRANËS	3468	8.25
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	934	7.37
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	270	9.08
UNIVERSITETI LUARASI	294	8.04
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	936	7.36
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	675	7.25
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA	309	7.75
UNIVERSITETI POLIS	483	8.32
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	1414	8.72
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	1053	7.43
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	237	8.88
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	222	8.76
Gjithsej	21968	7.80



Grafik 6

Ndër IAL-të publike, notën mesatare më të lartë në hyrje e kanë studentët e Universitetit të Mjekësisë.

Tabela 6 paraqet 25 programet e studimit të cilat kanë studentë të regjistruar me notën mesatare më të lartë.
Programet e studimit janë paraqitur të renditura sipas notës mesatare në rendin zbritës.

Tabela 6

Universitet Publike dhe Jopublike	Program Studimi	Nota mesatare sipas VKM
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Stomatologji	9.76
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Kompjuterike – diplomë e dyfishtë (Université de Technologie de Compiègne, Francë)	9.75
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Mjekësi e Përgjithshme	9.70
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Informatike	9.67
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	Mjekësi (Italisht)	9.66
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri të Sistemeve Elektronike – diplomë e dyfishtë (Université de Technologie de Compiègne, Francë)	9.62
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Farmaci	9.58
Akademia American Academy of Technology Tirana	Informatikë dhe Teknologji e Informacionit", i përbashkët me Rochester Institute of Technology	9.52
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	Mjekësi (anglisht)	9.51
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Ndërtimi	9.50
UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital	9.50
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Arkitekturë (Arkitekt)	9.48
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	Shkenca Politike/Marrëdhënie Ndërkombëtare me profile 'Marrëdhënie Ndërkombëtare' dhe 'Politikat dhe Legjislacioni i Bashkimit Evropian'	9.42
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë Ekonomike	9.35
Akademia American Academy of Technology Tirana	Inxhinieri Elektrike dhe Teknologji",i përbashkët me Rochester Institute of Technology	9.31
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	Bioteknologji	9.31
UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Kompjuterike	9.30
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	Stomatologji	9.27
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Teknikë Dentare	9.25
UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Ndërtimi	9.23
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Elektronike	9.23
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS	Mjekësi	9.21
UNIVERSITETI EPOKA	Arkitekturë	9.19
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	Arte Muzikore (Piano,Violinë dhe Harqe,Kanto)	9.17
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Kimike	9.14

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, studentët me arritje më të larta janë regjistruar në programin e studimit Stomatologji në Universitetin e Mjekësisë të Tiranës.

Kreu VIII

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas intervaleve të notës mesatare sipas IAL

Të dhëna mbi shpërndarjen e notës mesatare sipas segmenteve/interval të përcaktuara në nivel kombëtar për IAL publike/ jopublike, në nivel program studimi.


Tabela 7 tregon numrin e studentëve të pranuar në nivel IAL, sipas dendurive të notës mesatare në segmentet e njëpasnjëshëm të paraqitura më poshtë.

Tabela 7

Institucioni i Arsimit të Lartë	**4.5-4.99**	**5-5.49**	**5.5-5.99**	**6-6.49**	**6.5-6.99**	**7-7.49**	**7.5-7.99**	**8-8.49**	**8.5-8.99**	**9-9.49**	**9.5-10**	**Gjithsej**
Akademia American Academy of Technology Tirana								1	1	7	8	17
AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI			1		1	1	2	1	3	1		10
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA					9	10	17	12	11	8	1	68
AKADEMIA E SIGURISË					19	24	50	35	16	6		150
AKADEMIA IVODENT		1	12	22	17	18	19	13	13	5		120
KOLEGJI PROFESIONAL I LARTE GJERMAN I TEKNOLOGJISE		2	15	19	18	11	3	3	1			72
KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR					1	2		1				4
KOLEGJI UNIVERSITAR I BIZNESIT		16	55	56	25	24	16	10	4	2	1	209
KOLEGJI UNIVERSITAR INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË					12	17	40	44	43	41	33	230
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS		2	8	6	20	16	7	6	4		1	70
KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI		15	46	50	19	12	3	1	2			148
KOLEGJI UNIVERSITAR REALD	2	13	12	17	27	28	23	10	8	7	4	151
TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE					12	16	22	30	20	22	12	134
TIRANA COLLEGE OF TECHNOLOGY (ish KPT)	1	14	45	82	23	15	11	1	3			195
TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL		1	2	8	5	5	14	5	3	1		44
UNIVERSITETI ALDENT			9	16	72	123	112	130	145	111	21	739
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS		41	141	271	364	334	264	208	138	76	19	1856
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	8	123	171	180	205	217	141	92	50	22	2	1211

UNIVERSITETI BARLETI		18	71	106	95	103	87	72	59	25	9	645
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS			6	39	196	195	149	121	76	28	14	824
UNIVERSITETI EPOKA					3	14	41	54	87	153	145	497
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	7	59	81	65	96	81	44	40	25	17	5	520
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS		6	35	89	162	159	174	130	97	65	24	941
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	2	38	62	74	119	94	76	53	27	14	4	563
UNIVERSITETI I ARTEVE I TIRANËS	1	3	12	17	26	28	31	33	21	10	2	184
UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS						25	94	220	304	326	636	1605
UNIVERSITETI I SPORTEVE I TIRANËS		18	61	122	112	78	44	18	8	4	1	466
UNIVERSITETI I TIRANËS				1	306	420	599	693	658	594	197	3468
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	1	16	40	75	202	190	171	129	81	24	5	934
UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË					7	8	13	26	38	68	110	270
UNIVERSITETI LUARASI					30	57	55	56	56	35	5	294
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	1	21	45	65	212	190	175	116	69	28	14	936
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË		7	32	62	174	157	119	71	39	12	2	675
UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA			3	25	45	69	50	41	40	21	15	309
UNIVERSITETI POLIS		7	5	18	23	43	63	84	92	105	43	483
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS					65	86	171	197	228	343	324	1414
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY		8	47	128	185	219	180	133	74	59	20	1053
UNIVERSITETI WESTERN BALKANS					5	11	16	34	44	66	61	237
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA					3	14	19	40	53	51	42	222
Gjithsej	23	429	1017	1613	2915	3114	3115	2964	2641	2357	1780	21968

SHPËRNDARJA E DËNDURIVE (%) NË SEGMENTET E NOTËS MESATARE (sipas VKM) PËR STUDENTËT E REGJISTRUAR NË NIVEL KOMBËTAR




Grafik 7

Në **grafikun 7** tregohen përqindjet përkatëse për studentët e regjistruar me notë mesatare nga 4.5 deri në 10, të ndarë në njëmbëdhjetë segmente.

Rezulton se:

- **8.10 %** e studentëve të regjistruar në nivel kombëtar kanë notë mesatare në hyrje nga 9.50 në 10.00.
- **53.87%** e studentëve të pranuar e kanë mesataren e notave nga 7 deri në 8.99.



Grafik 8


Nëse i shikojmë shpërndarjet **(Grafiku 8)** sipas sistemit IAL publike,

Rezulton se:

- **8.24%** e të regjistruarve në IAL-të publike janë me notë mesatare nga 9.50 në 10.
- **36.14%** të regjistruarve në IAL-të publike janë me notë mesatare nga 8 në 9.49.

Në **Grafikun 9** tregohet shpërndarja sipas segmenteve të notave mesatare në IAL-të jopublike, sipas të cilit rezulton se:

- **7.79%** e studentëve të regjistruar në IAL-të jopublike kanë notë mesatare nga 9.50-10.
- **36.48%** e studentëve të regjistruar në IAL-të jopublike kanë notë mesatare nga 8 në 9.49.



Grafik 9


Në **Tabelën 8** janë paraqitur programet e studimit me të paktën 16 studentë, me notë mesatare nga 9.5 deri në 10 të renditura në rendin zbritës.

Tabela 8

Nr	**Universitet**	**Program Studimi**	**Numri i studentëve të regjistruar me nota mesatare(VKM) 9.50-10**
1	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Mjekësi e Përgjithshme	436
2	UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË	Mjekësi (anglisht)	127
3	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Informatike	126
4	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Stomatologji	120
5	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Ndërtimi	120
6	UNIVERSITETI I MJEKËSISË I TIRANËS	Farmaci	110
7	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri Kompjuterike – diplomë e dyfishtë	24
8	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	Inxhinieri të Sistemeve Elektronike – diplomë e dyfishtë	24
9	UNIVERSITETI EPOKA	Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital	16

Numrin më të lartë të studentëve, në këtë interval notash, e ka programi i studimit **Mjekësi e Përgjithshme** me **436** studentë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht shpërndarjen e studentëve më cilësorë nëpër programe studimi për 9 programet me të paktën 16 studentë të tillë.



Grafik 10

Kreu IX

Procesi i pranimit në programet e studimit të fushës mësuesi.

Programet e studimit të ciklit të parë të mësuesisë janë 36 nga **590** programe studimi në total.

Nga këto programe studimi 29 ofrohen nga IAL publike dhe 7 nga IAL jopublike.

Në të tri raundet, për programet e studimit që profilizohen mësuesi janë regjistruar gjithsej 1381 studentë (në 36 programe studimi).

Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi

Nga numri total i studenteve të regjistruar **21968**, në **590** programe studimi rezulton se **1381** studentë regjistrohen në Mësuesi:

- **6.28%** e të regjistruarve i përkasin programeve që profilizohen në mësuesi.
- **93.72 %** i përkasin të regjistruarve në programet e tjera të studimit.

Tabelat paraqesin numrin e studentëve të regjistruar në programet e mësuesisë për vitin akademik 2025-2026 si dhe krahasimin me vitin 2024-2025.


Viti akademik 2025-2026 Tabela 9

GJITHSEJ MËSUESI	STUDENTË TË REGJISTRUAR	NË %
	1381	**100%**
MËSUESI PUBLIKE	**1236**	89.50%
MËSUESI JOPUBLIKE	**145**	10.20%

Viti akademik 2024-2025

GJITHSEJ MËSUESI	STUDENTË TË REGJISTRUAR	NË %
	1408	**100%**
MËSUESI PUBLIKE	**1238**	**87.93%**
MËSUESI JOPUBLIKE	**170**	**12.07%**


Grafiku 11 paraqet numrin e studentëve të regjistruar në programet e tjera të studimit, në raport me programet e studimit që profilizohen në Mësuesi.



Grafiku 11

Grafiku 12 paraqet në përqindje numrin të regjistruarve në programet që profilizohen në mësuesi, në IAL publike dhe jopublike.

- **89.50%** e të regjistruarve janë në IAL-të publike.
- **10.50 %** në IAL-të jopublike.



Grafiku 12

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e mësuesisë

Për të analizuar cilësinë e studentëve të regjistruar në ciklin e parë në programet e studimit, të cilat profilizohen në mësuesi, është përdorur si tregues nota mesatare, e përllogaritur sipas VKM Nr. 436, datë 03.06.2020. Theksojmë se, kriteri i notës mesatare minimale është 7.5, në profilet Mësuesi, për vitin akademik 2025-2026.

Kështu në nivel kombëtar:

- Nota mesatare e të gjithë të regjistruarve në programet mësuesi **7.86**
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL-të publike **7.90**.
- Nota mesatare për studentët e regjistruar në IAL-të jopublike **7.51**.


Në nivel kombëtar, studentët e regjistruar në IAL-të publike në programet e mësuesisë kanë mesatare më të lartë se studentët e regjistruar në IAL-të jopublike.

Nga të dhënat e përpunuara rezulton (Tabela 10, Grafiku 15) se:

- notën mesatare **më të lartë** e ka University of New York Tirana me notë mesatare: 8.55.
- notën mesatare **më të ulët** e ka Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë me notë mesatare 7.12.

UNIVERSITETI	Studentë të regjistruar në mësuesi	Mesatarja sipas VKM për çdo IAL
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	13	8.55
UNIVERSITETI I TIRANËS	552	8.35
UNIVERSITETI BARLETI	23	7.76
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	22	7.75
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	183	7.67
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	178	7.59
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	78	7.48
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	107	7.46
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	43	7.38
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	95	7.36
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	37	7.33
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	17	7.24
UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	32	7.12

Tabela 10



Grafiku 13

Tabela 11 paraqet 10 programet e studimit të mësuesisë, në IAL publike dhe jopublike, të cilat kanë studentë të regjistruar me notën mesatare më të lartë.

Programet e studimit janë paraqitur të renditura sipas notës mesatare në rendin zbritës.

Tabela 11

UNIVERSITETI	PROGRAM STUDIMI	NR. i studentëve të regjistruar	Mesatare sipas VKM për çdo program
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	200	8.99
UNIVERSITETI I TIRANËS	Kimi	7	8.96
UNIVERSITETI I TIRANËS	Psikologji	110	8.65
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	Matematikë Informatikë	13	8.62
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	Psikologji	13	8.55
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek	10	8.54
UNIVERSITETI I TIRANËS	Matematikë	18	8.48
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Matematikë	4	8.42
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	Biologji	10	8.39
UNIVERSITETI I TIRANËS	Fizikë	7	8.23

Studentët më cilësorë janë regjistruar në programin e studimit Informatikë, të Universitetit të Tiranës.

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notës mesatare


Tabela 12 i referohet numrit të studentëve të pranuar në nivel IAL-je, sipas dendurive të notës mesatare, në intervalet e njëpasnjëshme, të paraqitura më poshtë.

Tabela 12

Nr	**Universiteti**	**6.5-6.99**	**7-7.49**	**7.5-7.99**	**8-8.49**	**8.5-8.99**	**9-9.49**	**9.5-10**	**Totali**
1	KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	8	5	1	2	1			17
2	UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	45	42	42	29	13	4	3	178
3	UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	32	30	17	8	7	1		95
4	UNIVERSITETI BARLETI	3	3	12	1	2	2		23
5	UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	29	20	11	3	9	5	1	78
6	UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS	5	2	6	6	2	1		22
7	UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	19	9	5	5	2	3		43
8	UNIVERSITETI I TIRANËS	58	49	65	98	140	111	31	552
9	UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	34	28	22	11	8	2	2	107
10	UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	47	41	33	29	18	10	5	183
11	UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË	16	10	2	3	1			32
12	UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	13	9	8	7				37
13	UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	1	1	1	1	5	3	1	13
	Gjithsej	310	249	225	203	208	142	43	1380

Në nivel kombëtar shpërndarja e notave paraqitet grafikisht në **Grafikun 14**.

Në grafik tregohen përqindjet përkatëse për studentët e regjistruar me notë mesatare nga 6.5 deri në 10 të ndarë në shtatë segmente notash.




Grafiku 14

Rezulton se:

- 3.12 % e studentëve të regjistruar në programet e mësuesisë në nivel kombëtar kanë notë mesatare në hyrje nga 9.50 në 10.

- afërsisht 31.01% e studentëve të regjistruar në programet e mësuesisë në nivel kombëtar kanë notë mesatare në hyrje nga 7.5 në 8.49.

Nëse shikojmë shpërndarjet sipas sistemit IAL publike dhe jopublike në segmente notash, do të kemi paraqitjen grafike si në **Grafikun 15**.




Grafik 15

Rezulton se:

- **3.11%** e të regjistruarve në IAL publike mësuesi janë me notë mesatare nga 9.50 në 10.
- **40.04 %** të regjistruarve në IAL publike mësuesi janë me notë mesatare nga 8 në 9.49.

Në **Grafikun 16** tregohet shpërndarja sipas segmenteve të notës mesatare në IAL jopublike.



Grafik 16

Rezulton se:

- **25.52%** e studentëve të regjistruar në IAL jopublike mësuesi kanë notë mesatare nga 8 në 9.49.

Në **Tabelën 13** janë paraqitur programet e studimit me studentë me notë mesatare nga 9.5 deri në 10 të renditura në rendin zbritës.


Tabela 13

UNIVERSITETI	PROGRAM STUDIMI	**Numri i studentëve të regjistruar me notë mesatare (VKM) 9.50-10**
UNIVERSITETI I TIRANËS	Informatikë	26
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	Matematikë Informatikë	3
UNIVERSITETI I TIRANËS	Psikologji	3
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Informatikë	3
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	Biologji	2
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	1
UNIVERSITETI I TIRANËS	Fizikë	1
UNIVERSITETI I TIRANËS	Kimi	1
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Matematikë	1
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Psikologji	1
UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA	Psikologji	1

Rezulton se:

- numrin më të lartë të studentëve, në këtë interval notash, e ka programi i studimit Informatikë në Universitetin e Tiranës me 26 studentë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht shpërndarjen nëpër programe studimi të studentëve më cilësorë, të cilat profilizohen në mësuesi.



Grafik 17

Kreu X

Procesi i pranimit në programet e studimit të gjuhëve të huaja.

Programet e studimit të ciklit të parë të gjuhëve të huaja janë 17 nga **590** programe studimi në total.

Nga këto programe studimi **15** ofrohen nga IAL publike dhe 2 nga IAL jopublike.

Në të tri raundet, në programet e studimit të gjuhëve të huaja janë regjistruar gjithsej 534 studentë (në 17 programe studimi).

Regjistrime në nivel kombëtar dhe sistemi shkollimi

Nga numri total i studenteve të regjistruar **21968**, në **590** programe studimi rezulton se 534 studentë regjistrohen në programet e gjuhëve të huaja:

- **2.43%** e të regjistruarve i përkasin programeve të studimit në gjuhët e huaja.
- **97.57%** i përkasin të regjistruarve në programet e tjera të studimit.

Tabela 14 paraqet numrin e studentëve të regjistruar në programet e gjuhëve të huaja.

Tabela 14

GJITHSEJ Gjuhë të huaja	Studentë të regjistruar	Në %
	534	**100%**
Gjuhë të huaja IAL PUBLIKE	**528**	**98.88%**
Gjuhë të huaja IAL JOPUBLIKE	**6**	**1.12%**

Mesatarja e studentëve të regjistruar në IAL në programet e gjuhëve të huaja

Për të analizuar cilësinë e studentëve të regjistruar në ciklin e parë në programet e studimit të gjuhëve të huaja është përdorur si tregues nota mesatare, e përllogaritur sipas VKM Nr. 436, datë 03.06.2020 i ndryshuar. Theksojmë se, kriteri i notës mesatare minimale për këto programe, për vitin akademik 2025-2026, është 6.5.

Në nivel kombëtar kemi:

- nota mesatare e të gjithë të regjistruarve në programet e gjuhëve të huaja **7.71**.


Nga të dhënat e përpunuara rezulton se (Tabela 15 dhe Grafiku 18):

- notën mesatare më të lartë e ka Universiteti Eqerem Çabej Gjirokastër me notë mesatare: 9.03

- notën mesatare më të ulët e ka Universiteti Aleksandër Xhuvani Elbasan me notë mesatare 7.24

Tabela 15

UNIVERSITETI	studentë të regjistruar në Gjuhët e huaja	Mesatarja sipas VKM për çdo IAL
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	9	9.03
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	72	7.78
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	23	7.74
UNIVERSITETI I TIRANËS	343	7.72
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	20	7.71
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	5	7.69
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	47	7.42
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS	1	7.42
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	14	7.24



Grafiku 18

Tabela 16 paraqet 10 programet e studimit të gjuhëve të huaja, në IAL publike dhe jopublike, të cilat kanë studentë të regjistruar me notën mesatare më të lartë.

Programet e studimit janë paraqitur të renditura sipas notës mesatare në rendin zbritës.

Tabela 16

UNIVERSITETI	PROGRAM STUDIMI	NR. i studentëve të regjistruar	Mesatare sipas VKM për çdo program
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR	Gjuhë Angleze	9	9.03
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	Gjuhë Gjermane dhe Angleze	19	8.12
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë Frënge dhe Gjuhë e shenjave shqipe	14	7.98
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë Angleze me profile: "Gjuhë angleze", "Përkthim dhe interpretim", "Studime britanike dhe amerikane", "'Marrëdhënie me publikun-program i përbashkët me Universitetin Kauno Kolegia"	222	7.81
UNIVERSITETI I TIRANËS	Gjuhë Gjermane me profile; "Gjuhë dhe komunikim", "Gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës", "Përkthim dhe interpretim"	28	7.81
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	Gjuhë Angleze	23	7.74
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	Gjuhë Angleze	20	7.71
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY	Anglisht	5	7.69
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	Gjuhë Angleze	53	7.66
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	Gjuhë Angleze	23	7.59

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, studentët më cilësorë janë regjistruar në programin e studimit Gjuhë Angleze, pranë Universitetit Eqerem Çabej Gjirokastër.

Shpërndarja e studentëve të regjistruar sipas dendurive në segmentet e notës mesatare


Tabela 17 tregon numrin e studentëve të pranuar në nivel IAL-je sipas dendurive të notës mesatare në intervalet e njëpasnjëshëm të paraqitura më poshtë.

Tabela 17

Institucioni i Arsimit të Lartë	**6.5-6.99**	**7-7.49**	**7.5-7.99**	**8-8.49**	**8.5-8.99**	**9-9.49**	**9.5-10**	**Gjithsej**
KOLEGJI UNIVERSITAR LOGOS		1						1
UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS	11	16	21	9	12	3		72
UNIVERSITETI ALEKSANDËR XHUVANI ELBASAN	5	5	3	1				14
UNIVERSITETI EQEREM ÇABEJ GJIROKASTËR		1			2	3	3	9
UNIVERSITETI FAN S. NOLI KORÇË	3	6	6	3	1		1	20
UNIVERSITETI I TIRANËS	61	75	93	63	31	17	3	343
UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË	4	4	9	3	1	2		23
UNIVERSITETI LUIGJ GURAKUQI SHKODËR	15	13	12	4	2		1	47
UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY		3		1	1			5
Gjithsej	99	124	144	84	50	25	8	534

Në nivel kombëtar shpërndarja e notave paraqitet grafikisht si në **Grafikun 19**.

Në grafik tregohen përqindjet përkatëse për studentët e regjistruar me notë mesatare nga 6.5 deri në 10, të ndarë në shtatë segmente notash.



Grafiku 19

Rezulton se:

- **1.50%** e studentëve të regjistruar në programet e gjuhëve të huaja, në nivel kombëtar, kanë notë mesatare në hyrje nga 9.50 në 10.

- **65.92%** e studentëve të regjistruar në programet e gjuhëve të huaja, në nivel kombëtar, kanë notë mesatare në hyrje nga 7 në 8.49.

-Fund-